



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË SHSTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.10.2020 (e Mërkurë), në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

z.Naim Pira, kryesuesi: Mirë se keni ardhur në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të ju përsërisht nënkryetarin e komunës, z.Hasan Aliu, juve anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, media të informimit, shoqëri civile si dhe të gjithë të tjerët të pranishëm. Para se me kalu në miratimin e rendit të ditës dua të ju informoj që kemi marr konfirmimin e ligjshmërisë së disa akteve nga zyra ligjore e MAPL-së. Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

z.Ali Bajrami: Përsërisht të nderuar të pranishëm! Për sot kam dy pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë. Një pyetje për vaksinat kundër gripit, jo vaksinat për Covid: a ka një datë kur munden përafërsisht qytetarët me u furnizuar me këto vakcina? Pyetja tjetër shkon për drejtorin e arsimit. Bursat që janë nda, ajo kategori është mirë që është stimulu, është kategori që duhet me u mbështet, është mirë që është rrit numri. Kisha pyetje për drejtorin: se kur do të fillon pagesa e këtyre studenteve?

znj.Mirlinda Sadiku: Përsërisht të nderuar të pranishëm! Unë kam pyetje për drejtorin komunal të arsimit. Që shtatë javë fëmijët e klasës së 9, shkolla fillore e mesme e ulët “Kenan Halimi” nuk mbajnë orën e matematikes. Sipas konkurseve që i kam përcjell, ka pas mjaft kandidat: ku ka qalu ky proces, pse fëmijët tonë mos me mbajt mësim në lenden e matematikes që shtat jave? Me një shtet normal kjo do të përbente lajm nacional, po tek ne shkojnë senet shkel e shko, këtë po e thamë me kompetencë të plotë, për arsye se edhe fëmiju im mëson në atë shkollë. Një çështje tjetër që kisha pas qef me pas përgjigje është, se në dreken zyrtare që e keni ngrën ju si stafe, është i nënshkruar fatura nga z.Sokol Haliti, këtu me rezulton që është 303 euro e 47 cent, e 69 euro është tvsh, ndërsa shuma totale që e ka nënshkrua kryetari është 452 euro e 50 cent. Në këtë kohë pandemie, në këtë kohë krize ku ka mungesë të të hyrave komunale. Unë mendoj që është një lluks i tepruar me hëngër mish të kombinuar 105 euro, me pi raki, tu e ditë që jeni përfaqësues zyrtar publik. Këtu e kam faturën, nëse e kontestoni për mu është e çuditshme, ndërsa për shumë gjera tjera jeni shumë me dorështrëngues, po kur të vjen puna tek drekat zyrtare në këtë kohë krize kjo dorëlibër jeni. Prandaj, kisha pas qef me pas një përgjigje. Pyetje prapë për drejtorin e arsimit,

a ka nxemje, a funksionon nxemja në shkollën fillore në Germovë, sepse e pash një status që e kishe postu një punëtorë aty e arsimit. Nuk e kam verifikuar, po deshta ta di për hirë të së vërtetës po edhe të gjithë atyre fëmijëve që mbajnë mësim në atë institucion.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e kam një pyetje për drejtorin e inspeksionit për çështjen e fermerëve, të cilëve ju kanë marr lopët: a do të paguhen dhe kur do të paguhen? Edhe një çështje tjetër për nënkryetarin, caktimi i lokacioni për taksista këtu, që kanë qenë këtu: a do të caktoni vend për këta.

znj.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar koleg! Unë pata dëshirë me qenë kryetari këtu me ja parashtrur një pyetje, mirëpo pasi që nuk është kryetari, me siguri nënkryetari mu përgjigjet siç përgjigjet zakonisht për të gjitha pyetjet. Në emisionin “Jeta në Kosove”, kryetari tha, që problemi i ujësjellësit në Pozharan është i zgjidhur, çka jam shumë e sigurt që problemi i ujësjellësit nuk është i zgjidhur në Pozharan, absolutisht fare, vetëm çka rrjedh uji në qeshmë, fatkeqësisht çdo herë kur kemi reshje atmosferike në Pozharan, ne përballemi me problemet e ujit. Uji nuk është i pijshëm, herë vjen uji i zi herë i kuq, nuk e di se në çfarë mënyre behet, qysh, tek. Kisha lut kryetarin që për pak pare mos me i lan pozheranasit pa ujë, po me bë filtrimin ose me e ble filtra, që sa kam informata, nuk kushton më shumë se 50-60 mijë euro dhe me e zgjedh problemin. Të gjithë banorët e Pozheranit janë të detyruar të enden në vende ku ka ujë të pijshëm, p.sh.: në Kabash, Lubishtë, për me mush ujë me bidona. Unë e kam lexuar, që vetëm një banderoll e bidonave po qendrojnë dikunde 50 vite, po mos flasim për pllastikan sa do të qëndron. Kjo edhe ka me ndot ambientin, po normalisht edhe ato bidona çka mushin ujë nëpër vende tjera, nuk mund të me qenë të pastër, kështu që, qytetarët tanë janë të rrezikuar prej ujit, prej papastërtive, prej atyre kamtave që e mushin ujin. Një problem shqetësues tjetër e kemi, edhe procka që vjen prej Ramjanit i ka përfshi të gjitha livadhet e “muhaxherve”, çka aty edhe është kundërmimi shumë i madh, edhe janë bë ato ara të pa punueshme. Edhe kjo po e shkatërron ambientin tek na. I lus që edhe kanalizimi i Pozharanit që derdhet në “bllat”, edhe këtë prockë me gypa ta bëjnë, ta bëjnë një zgjidhje ose ta qojnë deri tek vendi se ku u qu kanalizimi i Vitisë, që është bë një punë e mirë aty, po le të behet edhe për këto një punë e mirë. Edhe një pyetje e kam për drejtorin e shërbimeve publike. Elektrifikimi, sidomos në pjesën ku banoj unë, e kame cek edhe me herët, 20 ditë nuk punon një ditë punon. Duhet me bë një zgjidhje aty.

z.Taulant Haxhiu: Të nderuar koleg e ju të pranishëm! Unë po lidhem, para disa dite pata një intervistë tek Klan Kosova, pikërisht për sheshin “Njazi Azemi”, askush nuk është kundër këtij sheshi, por jemi kundër kualitetit dhe keqpërdorimeve që po bëhen në atë shesh. Unë edhe me herët e kam sqaruar aty, ka pas të vendosura kubza të betonit, tani kanë vendos kubza të thjeshta, vetëm e vetëm për ta keqpërdoruar parandë publike, për të faktorizuar këtë. Unë e kam një foto që ende një javë pa u vendos kubzat, ato kanë fillu të prishen. Kërkoj nga kamerat, shikoni ku kockat si kanë fillu të prishen ende pa u përfunduar sheshi. Sheshi është i bukur nga pamja, po kualiteti dhe qëndrueshmëria, shikoni, asnjë javë pa u ndreq, shi çfarë gjendje është. Kam edhe një pyetje për drejtorin e financave, kërkoj nga drejtori të ma siguron kontratën e muzeut që po rinovohet tek ish zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë. Aty po me duket që ka keqpërdorime dhe janë bë dy pagesa, kërkojnë nga drejtori të ma jep një kontratë të renovimit të muzesë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në debatin televiziv me kryetarin, tek “Jeta në Kosove”, kryetari deklaroi se brenda këtij afati do të përfundojnë shumë ujësjellës nëpër shume fshatra. Ujësjellësi do të jetë funksional, ndërsa nuk përmendet fare fshati Remnik, kështu që edhe banoret mu kanë drejtu pikërisht mu me pyetjen, se a ekziston në hartën e Komunës së Vitisë fshati Remnik, apo ne agjendën e kryetarit. Pyetja është për kryetarin, nuk du përgjigje nga askush tjetër përveç kryetarit, se kur qytetarët e fshatit Remnik do të kenë ujë të pijshëm.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në këtë pjesën e parë kam disa pyetje. Drejtori i Urbanizmit a ka leje ndërtimin e objektit tek shtëpia e mallrave, që po rinovohet apo ndërtohet? Pyetja tjetër, tek fillimi i ambulancës në Terpezë dhe. Më vjen mirë që është fillu, mirëpo ne e dimi që kemi pas dy vendime të

kthyme nga ministria, që nuk lejohet lokacioni. D.m.th pa vendim të kuvendit për lokacion. Unë e di që është nis tash, a u kane vetëm mos me e hup donacionin e me bë një shkelje të ligjit, apo çka është kanë këtu? Drejtorja e Kulturës duhet të mendoj, me sa e di xhamia në Germovë është e monument i mbrojtur, vetëm ka të kalon aty pari e shehë që një pjesë është duke u shem aty. Është mire aty të mendohet të rinovohet, se ajo mundet mu shemë. Për Drejtorinë e Financave, kam një kërkesë, aneks kontratë. Kam dëgju që ka për rregullimin e lumit “Morava”, me ma sjellë një aneks kontratë fizikisht dhe kisha pas një sqarim këtu tek forma, e kisha bë një krahasim në mes të tenderëve që jepen në Komunën e Vitisë. Do t’i marr vetëm disa parametra, të dy kontratat janë këtë vit të nënshkruar, kontrata për riparimin e shkollave. Vetëm po i përmendi disa parametra këtu para qytetarëve dhe para juve të nderuar këshilltar, sepse ne jemi ata që e miratojmë buxhetin. Këtu në renovimin e shkollave, sovatiimi i shkollave është 20 euro metra². Na krejt kemi pas sovatiime të shtëpive dhe e dimi sa shkon, është për 10 herë e rritur kjo vlerë, ndërsa pjesa që janë në kontratë, kalldajat nëpër shkolla që vendosen 150 kilovat, është 250 euro që qysh përgatiten kontratat, kaldaja 110 kilovat është 150 euro, kaldaja 90 kilovat është 100 euro llogariten tani ju. Pumpat 70 kilovat janë 50 euro, vetëm këtë llogaritne se qysh bëhet përgatitja e tenderi për me marr dikush. Po e marr edhe një parametër tjetër, furnizimi dhe vendosja e aparateve kundër zjarreve, aparatet kundër zjarrit që vendosen nëpër objekte publike 10 cent, është me ble aparatin me kontratën e tyre, po asnjë nuk vendoset vetëm me kalu kontratën. Po e bëjë vetëm një krahasim, është kontrata tjetër, mirëmbajtja e pajisjeve kundër zjarrit, mbushja për një kilogram që behet e aparateve kundër zjarreve është 75 cent. Vetëm me mush një kilogram, ndërsa krejt aparati me e ble 10 cent. Ose testimi i aparateve është 7 euro e 50 cent, ndërsa pse nuk i merrni aparatin e ri nga 10 cent. Unë po i paguaj, vetëm mos shkoni me i testu që shumë thjeshtë janë kontrata. Këtë vit janë të nënshkrume.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje te nderuar të pranishëm! U përmen nxemja tek shkolla në Germovë. I përkas asaj shkolle, sepse është paralele e ndarë e Goshices, ka problem ajo shkollë që tri vite me nxemje, bile gjendja në të cilën është edhe tavani ku është zyra e arsimtarëve rregullisht ka pikë kazani i cili është i vendosur aty. Unë mendoj që tash e tri vite është ai problem, është përgjegjësi bile në këtë punë e kemi qit në pozitë të keqe edhe drejtorin e shkollës. Ai vazhdimisht që një kohë ka kërku me e rregullu këtë problem, mirëpo përgjegjësia mbetet dikun tjetër, ku me një far forme kanë të drejt edhe prindërit edhe nxënësit që mu anku. Kemi kërku disa herë që ambulanta e cila është djeg në fshatin Goshicë, përgjigjen e fundit që e morre prej kryetarit ne “Jeta në Kosove”, që ajo është në pronë private, unë kam edhe dy bashkëvendas këtu, që këta janë nga mosha më të moshuar se unë. E dinë më mirë, mirëpo ajo ambulancë po thuhet që prej që ekzistojnë mjekët ajo nuk është pronë private. Nëse do me i ik përgjegjës, atëherë do të marrmi përgjegjësi, ne do ta mirëmbajmë, do ta pastrojmë dhe do të fillojmë me rregullimin e ambulancës. Ajo le të mbetet përgjegjësi e kryetarit, mirëpo ajo që e ka thanë nuk ekziston, është e pavërtetë, nuk është pronë private. Është e vërtet që ka punu një punëtor, ka ardh u vendos aty, ju ka mundësua mu vendos shumë, mirë që ju ka mundësu, mirëpo pronë private nuk është dhe kërkoj që kjo mos të mbyllet. Uji në Goshicë nuk është përfundu ende, banorët e kërkojnë ujin, mirëpo kemi qenë tek drejtori i financave, na ka premtu, edhe si këshill i fshatit kemi kërku me u rrumbullaksu ai projekt, mu bë shpumje prej një ane në anën tjetër. Po kërkojmë që rrjeti me shku edhe tek shkolla. Paramendone ju, tek shkolla nuk ka shku rrjeti i ujësjellësit, si mund të themi që është funksional.

z.Ali Bajrami: Sejdes si bashkëfshatar. Nuk janë tu deshtë me politizu, jam me u kry ajo ambulant. Besoj nëse sigurohen mjetet do te kryhet. Pjesa e panelit është pronë private, që është ble nga banuesi që ka qenë aty, pjesa e ambulancës është krejt diçka tjetër. Kështu që, kryetari nuk ka thanë decitivist që nuk kryhet edhe nuk jemi për mos me kry, private ka than pjesa që është e blemë.

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar këshilltar komunal! Po mundohem me ju përgjigj pyetjeve. Kontrata pe muzeun, këtu ky objekti që është tu renovu në Viti, kontratën ju sjelli në mbledhjen e radhës, po si informacion, tani ky është një bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Fondacionit Kosovar për

Trashëgimin Kulturore Pakufij. Projekti është bashkëfinancim, vlera e përgjithshme e projektit është 29 mijë e 500 euro. 51% të këtij projekti e financon Fondacioni Kosovar për Trashëgimi Kulturore, kurse pjesën tjetër, 49% Komuna e Vitisë, apo shprehur në shumën financiare, 14 mijë e 500 euro. Pra, në këtë drejtim kjo procedurë e tenderimit, ne vetëm e monitorojmë, i udhëheq Fondacioni për Trashëgimi Kulturore. Edhe aneks kontratën për rregullimin e lumit “Morava” nuk e kam me veti edhe këtë në seancën e radhës ja u siguroj.

z.Basri Aliu drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U bën disa pyetje për drejtorin e arsimit. Një pyetje ishte kur do të fillon pagesa e bursave për studentet. Ne jemi duke e pranuar dokumentacionin, si gjyrollogarinë bankare dhe besoj si të përfundojnë këto, do t’i dërgojmë për ekzekutim të mjeteve. Mirlinda ngriti çështjen tek mësimdhënësit i matematikes në shkollën “Kenan Halimi”. Po personi që ka qenë duke punuar mësimdhënës, e ka liru pozitën për arsye personale. Ne e kemi shpall konkursin, besoj që edhe ti nuk je për mi thy rregullat e ligjet, prandaj kemi shku bazë kësaj e kemi shpall konkursi në konkursin e parë që ka qen prej 15 dite nuk ka pas konkurrent adekuat që i plotëson kushtet, atëherë jemi detyru që ta shpallim konkursin për herë të dytë. Tani shpresoj që do të behet zgjedhja edhe për këtë vend pune. Ndërsa unë e kam informacionin, që drejtori i shkollës, i cili është i të njëjtit profesion, është duke e zëvendësuar orët e matematikes. U cek edhe një problem tek fshati Germovë, tek nxemjet, vërtetë është që ka ngecje, nxemjet ekzistojnë po nuk funksionojnë për momentin, për shkak se një projekt që ka qenë me Bashkimin Evropian, paraqitja e një kazani ka dal që sun po muj me gjete, ndërsa ne vetëm kemi intervenu. Tash do ta terjekmi atë, do ta riparojmë që kështu shumë shpejtë do të zgjidhet edhe ky problem.

znj.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Vaksinat sipas institutit të shëndetësi në nëntor do të vinë. Sa për informatë e kemi, se vitin e kaluar kane qenë 2500, këtë vit i kemi bë kërkesën për 4000 vakcina.

z.Skender Ahmeti, drejtor i inspeksionit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishte një pyetje nga Basri Sylejmani. Është çështja e asgjësimit të lopëve tek fermerët që kanë rezultuar pozitiv në tuberkoloz. Janë dikun 47 krerë në 10 fshatra të Komunës se Vitisë. Pas shqetësimeve që i ka bë agjencioni i veterinars, në bashkëpunim me inspektorin tim veterinar dhe praktikant veterinar që janë në Viti, kane rezultuar pozitiv 47 krerë dhe janë asgjësuar të shtunën e kaluar dhe të dielen në mënyrën më të mirë të mundshme. Tash për tash jemi tu e bë edhe testimin e kafshëve ne bruseloc, që fatkeqësisht edhe buuseloca është e pranishme tek fermat e fermerëve tonë dhe natyrisht ato të cilat dalin pozitiv do të asgjësohen. Të gjitha ato kafshë të cilat merren dhe asgjësohen do të kompozohen, varësisht prej racës e cila kategorizohet tek fermeri që është marr. Procedurat administrative ne i kryejmë, i qojmë në agjencion dhe në momentin e fundit ata e bëjnë ekzekutimin.

z.Ajet Sallahu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetje që i beri z.Bekim Azizi, Ligji i Ndërtimi Nr. 04/110 parasheh, se për një leje nderimi duhet me se pari të aplikohet për kushte të ndërtimi e pastaj të aplikohet për leje nderimi pas marrjes se lejes se ndërtimit. Mirëpo në nenin 18 parashihet që aty ku ka plan rregullues urban nuk kërkohet kushte ndërtimi. Pronari ka bë kërkesë gabimisht për kushte ndërtimi, aty ku nuk kërkohen kushte e ndërtimit i është refuzuar kërkesa. Atëherë kërkesë për nderim nuk kemi ende, ky vendim është kthy me 26.10.2020.

z.Nexhmedin Jakupi, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pate pyetje rreth ndriçimit publik. Normal se mirëmbajtja është problematikë në vete, doken edhe defektet në ndriçimin publik. Fatkeqësisht nganjëherë edhe qytetarët e paautorizuar e prekin ndriçimin publik, pastaj ne na shkaktojnë telashe, pastaj na merr kohë deri ta zbulojmë defektin. Edhe rasti konkret në Pozharan ka qenë një problem i tillë. Dikush ka bë një intervenim të paautorizuar edhe për këtë arsye u shkaktu ai problem. Tani e kemi rregullu dhe besoj që duhet të keni durim edhe pak.

z.Milot Lala, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Për hirë të opinionit dola para foltores me e diskutu. Së bashku me zyrtarin e kulturës kemi qen tek vendi i ngjarjes, kemi pas takim edhe me Këshillin e Fshatit Germovë. Objekti është nën mbrojtje të trashëgimisë kulturore nga Ministria e Kulturës. Jemi tu e shqyrtu mundësinë së

bashku me Ministrinë e Kulturës të behet renovimi i objektit. Kemi pas kërkesë nga Këshilli i Fshatit Germovë, që objekti të rrenohet, të lirohet hapësira aty për objektin e ri që është ndërtu, po ajo në asnjë formë, as me një mënyre nuk lejohet që të behet rrënimi përderisa është nen mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Unë po besoj që do të kemi mbështetje nga Ministria e Kulturës dhe të behet renovimi i objektit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtorët u përgjigjën në pyetje. Po mundohem të ju përgjigjen pyetjeve që ishin për kryetarin, ku në këtë rast përfaqësoj unë, ku një nder pyetjet ishte një faturë prej 452 euro. Fillimisht këshilltare kam prit që ti ki me thanë faleminderit në përgjigjen në afat ligjor të cilën tu kemi përgjigj në kërkesën e juaj, që është obligim i joni dhe duhesh me falënderu tjetrën që asnjë të msheft nuk e kemi, po gjendja reale është, ajo a kanë hëngër mish të kombinuar apo raki, pavarësisht qajo ka qenë gjendja reale, qashtu ta kemi paraqit. Sa i përket shumës, ka qenë në vizitë e spektrit të gjerë të Ministrisë se Kulturës, jo vetëm ministra po edhe të kabinetit të saj, e ki të evidentume edhe pjesëmarrjen, se sa kanë qenë në atë drek. Pyetje tjetër ishte çështja e uji të pijes, një prej atyre që e bëj një angazhim shume të madh rreth kësaj çështje, nuk du këtu me qenë mbrojtës i kerkujt, po jam tu marr shumë vetë me atë çështje, megjithatë është një çështje shumë e rëndë, me vështirësi shkon, sepse nuk po varet vetëm prej neve. Shqetësimi që u ngrit për Pozharan, kryesuesi i kuvendit e ka ngrit nja 20-30 herë, bile me një takim tjetër ku nuk ishte i domenit të ujit, e shtroj edhe me fotografi, e kish pas ujin e Pozharanit dhe përgjigjja nga enti higjenik në regjion, ka marr se ai kontrollohet dhe është ujë i pijshëm. Megjithatë, ne përveç kontratës që e kemi që e pagjumë, duhet t'i besojmë profesionistëve. I kuptoj shqetësimet e tua, në këtë gjendje jemi, a duhet të bëjmë përpjekje në çdo takim të cilin e kemi edhe me CDI-në e ngrismi që nuk përjashtohet kurrë, edhe kryesuesi i kuvendit që merr pjesë në çështjen e mungesës se ujit po edhe çështjen e kualitetit të ujit në Pozharan, po por megjithatë çështjet janë qeshtu qysh janë. Çështja e kanalizimit është shumë brengosese për shumë lokalitete, sepse kemi bë kanalizime që i kemi hek nga shpia, i kemi shkarku ja në lumenj ja ne livadhe. Po, e dimë atë problem, po megjithatë kapacitetet buxhetore janë këto dhe në të ardhmen parashihen disa gropa apo gjithherë jemi aplikues nëpër të gjitha fondacionet, në rast që muj me arrit me përfiku një fabrikë të trajtimi të ujerave të zeza, që ajo kushton me miliona. Çështja e sheshit "Njazi Azemi". Unë konsideroj se është tu bë një shesh i bukur, i mirë, e për kualitet janë personat tjerë që e vlerësojnë. Sot është herët me fol për kualitet, për shkak se ende nuk ka pranim teknik, po megjithatë ai shesh ka qenë në debat me qytetar, e ka pranu si të tillë. Unë konsideroj, që Vitisë është tu ja shtu një bukuri, ndërsa në kualitet, le të merren profesionistet, unë nuk du të përzieh me në atë. Jam që kualitetit të jete me i lartë i mundshëm. Pyetjet e Bekimit që u parashtruan. Këto pyetje u desh me ja bë para një jave në KPF, e kishim menaxherin e prokurimit aty, në aspekt profesional është i thirrur me tu përgjigj ai, por megjithatë kur të do ti ne e thirrmi në seancë dhe ai përgjigjet.

z.Bekim Azizi: I kame ngrit këto shqetësime kur ka qen edhe shefi i prokurimit, unë nuk bena pyetje që ti mu përgjigj, unë vetëm i njoftova se si bëhen këto gjera.

znj. Mirlinda Sadiku: Te Drejtoria e Arsimit, drejtor, konkursi i parë është hap me 24 shtator 2020, ndërsa konkursi i dytë me 20 tetor 2020, sa po i morra të dhënat nga wep e komunës, po nashti nuk e dini që me ligjin që ka të bëjnë, se ne jemi shërbyes profesionist, ju keni të drejtë të merrni arsimitar me një normë e gjysmë, edhe fëmijët mos të mbesin në lenden me kryesore, mos të mësojnë shtat jave. Tek nënkryetari, unë e kam problem që e keni shpenzu 452 euro për arsye se është taksë e imja edhe e të gjithë qytetarëve. Mu mu ka dokë shumë e madhe, po edhe problemin e dyte e kame se qeto kur ti mbledhmi këtu nuk po dalin 452 euro edhe nuk e kame njëjtë me tu falenderu, se tek e fundi e ki obligim ligjor që duhet me mi dhënë dokumentet. Problemin e kam që kjo shumë nuk përputhet me totalin e shumës në fature.

z.Basri Aliu drejtor: Duhet me e ndjek anenë procedurale, sepse është problem pagesa nëse e marrim një mësimdhënës pa e ndjek anën profesionale. Me rendësi është, që drejtori i shkollës është i të njëjtit profesion edhe orët e mësimi janë duke u mbajte. Nuk qëndron ajo që po thua ti. Në konkursin e parë që kanë konkuru, kanë qenë

vetëm deri me 180 kredi konkurrentet, prandaj sipas ligjit aty ku nuk janë plotësu kriteret duhet të përsëritet konkursi. Prandaj e kemi përsëritë konkursin.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Duhem të ndërlidhem me Bekimin, tek kontratat. Ka mujt mu refuzu në fillim, ka mujt edhe mos me u refuzu, nuk ka lidhje pse koshton 0.10 cen, po atë mall duhet me e ble. Na kemi pas rastin, ku unë isha menaxher i prokurimit, dhe kam pas dy herë raste dhe kon traktorin e kemi obligu me naj sjell mallin. Ai ka dal me humbje me një rast, dikun 4000 euro, se i kemi thanë kemi me ndërmarr masa ligjore. Fatkeqësisht këto sene bukur shumë ka në Viti, po me vjen keq me thanë, unë i kisha thanë kryetarit, le të bisedon me menaxherin e prokurimit. Unë dashta me përshëndet ekzekutivin, kryetarin e komunës, që janë kujdes për rregullimi e një kanalizimi, që ka qenë duke u derdh në pronat, është rregullu mirë dhe qytetarët janë shumë falënderues për këtë.

z.Taulant Haxhiu: Askush nuk është tu e kontestu që Vitia nuk ka pas nevojë për një shesh, po nga pamja vizuale siç po e quajmë, pok kualiteti është i dobët. Ja siç shihet si është i prishtë, shikone në foto, asnjë javë nuk e ka që u vendos kupëza, po nëse ka edhe dy reshje të shiut çka bëhet këtu. Shif foton.

z.Nexhmedin Jakupi, drejtor: Kërkesën për mirëmbajtjen e pajisjeve kundër zjarreve, përgjegjësi është e drejtorisë sonë edhe na këtu e kemi fillu që nga 2016-17 t'i furnizojmë me aparate në shëndetësi, në arsim, pasi që me vite nuk ishin mush ato aprate, nuk ishin mirëmbajt dhe shumë objekte të shëndetësisë nuk kishin pas fare aparate. Më befasoj Bekimi, pasi që e kam edhe kontratën për pajisje kundër zjarrit dhe që dy vitet e fundit ne i kemi bë kërkesë Zyrës së Prokurimit, për draftë që vetëm të mbushen aparatet. Paramasën e bënë njësia shpenzuese. Ne si drejtori e bëjmë paramasën, ndërsa Zyra e Prokurimit merret me çmimin që e ofrojnë operatorët. Unë nuk kam pas njohuri që një aparat i ri ka kushtu 0.10 cent, kisha pas me tregu për cilën kontratë, sepse unë kontratën që e kamë këtu nuk është kjo.

znj.Idajete Pira: Nënkryetar, ti mirë thave, nëse e kanë vlerësu ekspertët, unë jam dëshmitarë. A mundësh me më dhanë një përgjigje, a ka shtëpi vetëm një shtëpi në Pozharan që nuk mush ujë dikun? Po qyshe po thu ti, bani çka të thamë unë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Kërkush nuk e kontestoj 452 euro Mirlinda, prandaj nuk e di pse debatojmë për këtë. Nëse ki fije dyshimi, për këtë janë organet e drejtësisë. Çështjen e kualitet të sheshit, është mendim i imi, konsideroj që është e hershme të debatojmë sot, kur kocka mund të thehet, aty është tu punu. Kur të kryhet, bëhet pranimi teknik, i sheh ato të cilat janë jo kualitet, e shtrojmë pyetje dhe debatojmë. Drejtoresha Idajete, nuk e di a bleni krej ujë, unë thash fjalë të institucionin që i bën analizat e ujit në Viti dhe në Pozharan.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit të gjithëve! Tani po kalojmë tek rendi i ditës.

R e n d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendi Komunal.**
- 2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- shtator 2020.**
- 3. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2019.**
- 4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Vitin 2019.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.**
- 6. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.**
- 7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale NPSH “ARENA SPORT” në Kabash.**
- 8. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal e kryetarit të komunës së Vitisë me Komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**

b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e miratimit të nismës së kryetarit të komunës së Vitisë me Komunitet e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

c) Propozim vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunitet e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

9. Informatë për raportin e përformances për vitin 2019 të Komunës së Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush rrethë rendit të ditës ju lutëm?

z.Hasan Aliu nënkryetar: I kemi edhe dy propozim vendime, ku në KPF, me propozimin e këshilltarit nga LVV-ja, ka dal një propozim, ku janë dakordu shifat e grupeve të takohen një ditë dhe janë koordinuar ata që ishin pjesëmarrës, që ta përgatitmi një propozim vendim që të ju vjen juve sot si pikë e veçantë në kuvend, që është fjala për të gjitha ata që e kanë humbe një anëtar të familjes nga Covid 19, të kompensohen. Propozim vendimi tani do ta merrni dhe ta shqyrtoni, shuma ka qen 500 euro, po nuk është cek në propozim vendim, dhe propozim vendimi i dyte që vjen në seancën e 30.06.2020 na ka ndodhe një gabim, ku ne propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkur prej 15 vjet, ndërsa në ministri na ka shku propozim vendimi për 4 vjet. Komisioni tash me cilin vendim me ju qas, atëherë ka qenë dashur me ju referu ati që ka shku në ministri, e tashti kemi sjellë propozim vendim për ndryshimin e atij propozim vendim, qe të ndryshohet nga 4 vite në 15 vite.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit nënkryetar! Qes në votim për miratim rendin e ditës me këto pika të propozuar nga nënkryetari. Nga të gjithë të pranishmi u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendi Komunal

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë. Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- shtator 2020

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtoria për Financa është e obliguar çdo tre muaj t'i paraqes pasqyrat financiare të ekzekutimit të buxhetit. Për këtë vit, në këtë drejtim e kemi dorëzu me kohe në ministri dhe tek ju. Jemi të kënaqur me shpenzimin e buxhetit për këtë periudhë janar-shtator. Duke u bazuar në situatën e krijuar në përgjithësi nga Covid 19, shifet se bazë e pasqyrave financiare, buxheti i Komunës së Vitisë është shpenzu me një përqindje solide, 91.%. Unë besoj, që në fund të vitit do të ketë një realizim edhe më të mire sikur viteve të tjera.

Procesmbajtësi: Drejtori para këshilltarëve prezanton pasqyrat. Vazhdon drejtori duke thënë: “materialin këshilltarët e kanë marr me kohë, jam në dispozicionin e juaj për pyetjet shtesë”, - përfundoi fjalën drejtori z.Rama.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës.

znj. Mirlinda Sadiku: Drejtori e ceku shumë mirë që ka pare më pak në kuletën e komunës, mirëpo po me intereson ta di se çka do të bëni, se 100 mijë euro i kemi marr për Covid, që nuk kanë qenë të planifikuara. I kemi 145 mije euro vendime gjyqësore, e ku asnjëherë nuk po planifikohen, e ato pare merren nga buxheti komunal. E thatë edhe vet, që 180 mijë euro janë më pak, është mjaft shqetësuese kur ta analizojnë me 2019, ka një ramje drastike prej 313 mije euro duke e krahasu me periudhën 2019. Po ashtu ka një ramje të madhe edhe të donacionet, Është evidente një çështje, që ka të bëjë po ashtu me drejtorinë e juaj, bursat për student. Konkursi u hap qysh në nëntorin e vitit 2019, ndërsa tash pas një viti këta studenta po përfitojnë nga bursa, çka në rregulloren që e kemi miratu në kuvendin komunal, ka qenë, që studentat të përfitojnë bazë të vitit akademik. D.m.th vitit 2019-2020 u duft mu harru kur ata studentë duhet me përfitu nga bursat. Sot, këto ditë nga DKA-ja do duhet të kishim konkurs për bursat e vitit 2020-2021, sepse ka fillu viti akademik, prandaj nëse ki përgjigje në këto çështje, si do të qëndroni me buxhetin e vitit të ardhshëm, kur dijet që të hyrat vetanake kanë kogjo një ramje. Më intereson ta di tek kodi 13130, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, transporti i nxënësve 7649 euro. Ne dimë, që nga 12 marsi nëse nuk gabo, nxanësat kanë kalu në mësimin online dhe kjo shumë është pagu, kur dijet që nxënësat nuk janë transportu, nuk ka pas nevojë për shkak të mësimin onlin. Një përgjigje e du për këtë. Tek shpenzimet e telefonisë fikse, nuk e

dijë a ka një arsye logjike që mu shpenzu 7274 euro, kur ne e dimë, që të gjithë jemi në atë rrjetin që e kemi “telefoni mobil pa pare”. Pse ka nevojë një shumë kaq e madhe mu shpenzu në telefonin fikse. Tek kodi 13509, pajisje tjera, furnizime për të gjitha programet 5773 euro. Nëse ki informacione se çka janë këto pajisje tjera, që janë furnizu të gjitha programet, mirëmbajtja e ndriçimit publik, e kemi 20 mijë euro, e kemi shumë ndriçime publike që nuk funksionojnë, pagesat po behet, po kur vjen puna tek funksionalizimi po ka ngecje. Derivate të veturave, 23 mijë euro, na jemi të vetëdijshëm, që me vendimin e qeverisë, shumë zyrtar që punojnë në komuna dhe drejtori kanë pas edhe orarin e punës te rekrutuar. Neve si LVV, na u ka dokë një sasi e madhe e shpenzimeve të derivateve, një dukuri që po përcjellët vit pas viti, është mirëmbajtja e veturave. E kam thanë njëherë po e përsërisë prapë, 21 mijë e 391 euro, d.m.th përafërsish 10 drejtori përafërsisht nga 2000 euro. Kam thanë edhe atëherë, mos është më mirë me ble vetura të reja, se sa një shumë kaq e madhe mu shpenzu në mirëmbajtje, a kur ta krahasojmë me mirëmbajtje të shkollave 70 euro, perime është absurde. Vendimet e gjykatave, shumë ka padi, siç po shifet, në shumë komuna mësuesit edhe po i fitojnë lendet. Në fillim të qeverisë keni pas thanë, që keni trashigu borxhe shumë, po edhe ju nuk do ta leni gjendjen hiq më mirë. Tek korniza afatmesme buxhetore, gjithmonë aty është hijezu me të zezë, kur në hapjen e konkurseve, të kihet parasysh edhe buxheti, për arsye se njerëzit po hynë në sistem, anipse sipas një hulumtimi, drejtori i arsimit, që e ka bë KDI-ja, i kam të dhënat, raporti mësimdhënës nxënës në Komunën e Vitisë është në nivelin e njëjtë me të Kamenicës, kjo është mjaft shqetësuese. Po me intereson edhe këtu ku i ki paraqit investimet kapitale, e ke përmend si investim kapital trotuarin në Ramjan, më ka rastisë me pa, që ai tretuar ish i asfaltum. Aty nuk kish tretuar, e këtu e ki paraqit, tash nuk e di a është qaj tretuar, ai nuk ish tretuar, po ish komplet i asfaltuar edhe në anën e majtë e ki në dalje të Pozharanit, po edhe në anën e djathtë në hyrje të Ramjanit. Po ashtu edhe tek investimet kapitale, që është bë tek rruga Skifteraj – Stubell, 64 mijë e 127 euro. Na jemi dëshmitar se sa shumë është demtu, tash gjate dimrit ndoshta prapë do të dëmtohet. A mendon që prapë ne duhet të harrojmë në vitin e ardhshëm, për shkak të punimeve të dobëta si dhe kur e dimë që komuna harton projekte, shpenzon taksa 58 mijë euro, plus mbikëqyrja e projekteve: pse drejtor po ndodhin këto gjera?

z.Jakup Demiri: Unë e kam tek derivatet e veturave. Janë 23 mijë e 98 euro, që m’i mbledh dalin mbi 27 mijë litra naftë, që i bien mbi 150 mijë kilometra. E po me doket që është vlerë e madhe. Tek regjistrimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, edhe kjo shumë është e madhe. Shpenzimet tek gjykatat, a muj me ditë cilat janë lëndët, me pas emrin e lendeve.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ne qe jemi në KPF, atje po e shprehim mendimin tonë, po i thojmë ato që i kemi mi thanë. Këtu nuk po du me i përsërit ato që po i thojmë atje, po këtu p.sh.: mallra dhe shërbime, buxheti i aprovuar është 1 milion e 783 mijë 809 euro, alokimi është 1 milion e 231 mijë e 721, d.m.th kur ta krahason me nëntëmujorin, aprovimin u buxhetit dhe alokimi është mirë, por nga ky buxhet kanë tepru 307 mijë e 840 euro për nëntëmujorin e parë, kur të ja shton edhe 552 mijë euro që kanë mbet për këtë tremujorin e katërt, i bien, që prej muajit tetor e deri në fund të vitit janë edhe 859 mijë e 564 euro pa shpenzu. D.m.th tek shërbimet dhe mallrat çdo viti kështu jeni tu ja bë. Subvencione janë 262 mijë 773 euro, të aprovuara për këto muaj janë nda vetëm 94 mijë euro, d.m.th nuk janë nda 181 mijë euro, i keni lan vetëm për fundvit. Shpenzimet kapitale, alokimi është bë gati 90,% por nga ky alokim kanë tepru edhe 578 mijë janë pashfrytëzuar për tremujarin e fundit. D.m.th edhe 900 mijë euro që i kemi nda nga pagat dhe mëditjet tona që kanë mbete, gjitha këto bëjnë 1 milion e 478 mijë euro, janë të pashpenzuar për investime kapitale. D.m.th kjo po i bien, që unë po dyshoj që këto investime kapitale kanë mu bë shkel e shko, faturat kanë me ardh edhe ka mu bë buxhetit 99.99%. Kjo për mu është e patolerueshme. Jam kane ithtar gjithmonë, që shpenzimet të ndahen me nga tremujore, po ju gjithmonë i leni në fund, në tremujorin e fundit me pas shpenzim shume të mëdhaja. Të hyrat vetanake të planifikuara dhe të realizuara janë shumë dallim i madh, shume dallojnë, janë planifiku shumë, janë realizu shumë pak, disa vende e kane kalu 100%. Tek investimet kapitale, ndriçim dhe tretuar, nuk ka as një vlerë më e madhe që duhet mu kanë. P.sh. me një fshat është shtru tretuar dhe ndriçim më shumë, me e tregu një vlerë, p.sh.: nga këto 240 mijë euro me një fshat është punu me shumë, me cek në këtë fshat është punu kaq metra e me një kaq. Po ne nuk dimë asgjë për këtë. Tek bashkëfinancimi me fondacionin Kosovë për trashëgimi kulturore, a është dyvjeçare kjo apo njëvjeçare, sepse po shkruan vetëm 14 mijë e 500 euro, nuk shkruan 29 mijë e 500 euro. Nëse është me punu për dy vite në rregulle, a nëse është vetëm për këtë vit 14 mijë e 500, çka është punu tek kjo ndertës me 30 mijë euro. Ky është mendimi im personal, me material të fort ajo ndërtesë ish maru prej temelit. Riparimi nëpër shkolla, 70 mijë euro. Në shumë shkolla kishit riparu po nuk e di çka quni ju riparim, a vetëm me ja dhënë një ngjyrë 15 euro, a ai quhet riparim. Për ujë nuk pash kurgja, që janë hargju po ju pyes, se parëzit u tha, pranimi teknik. Për punët e këqija që janë bë, a u

denu naj person që e bën pranimit teknik në Komunën e Vitisë? Të gjitha pranimet teknike bëhen, po dyshoj sipas meje që me pare jepen para dhe e pran qyshdush, po për këtë po thamë, ka qenë dashur e duhet të dënohen ai person që e bën pranimi teknik nëse sa në rregull. E tani qytetarët po dyshojnë, që çdo punë që kryhet në Komunën e Vitisë, kryhet, sasi boll shumë, po nga cilësia shume pune e keqe. D.m.th, a dënohet najkush për pranime që janë jocilësore?

z.Ali Bajrami: Përshëndetëj të nderuar, përshëndetëje edhe kryetarin që na u bashkëngjit në punimet e kuvendit. Pasqyrat financiare janar-shtator 2020, është obligim ligjor që i ka sjell drejtori, janë pasqyra që pasqyrojnë mënyrën e shfrytëzimit të parave që i kemi të parapara dhe të ndara nëpër të gjitha drejtoritë. Ajo që u cek nuk do ta përsëris buxheti i shpenzuar në përqindje 91.6% është mirëmenagjur dhe mirëshpenzuar. Ajo që vlen të ceket tek shpenzimi i buxhetit, tu fillu prej Zyrës së Kryetarit dhe nëpër të gjitha drejtoritë, është mbi 90% ngec Drejtoria e Financave. Po e dimë që aty është një përqindje më e vogël, shkak se tek projektet investime kapitale kemi tremujorin e tretë dhe të katërtin bëhen punët me të mira, prandaj shumë besoj që përqindja e viteve të mëparshme e shfrytëzimit të projekteve për investime kapitale do të jetë ajo përqindje që ka qenë. Tek të hyrat vetanaka, jemi të vetëdijshëm për situatën me Covid, prandaj edhe kjo ka ndiku në masë të madhe. Kisha pas me e veçu shpenzimet e mjeteve të projekteve kapitale, në këtë nëntëmujor kemi shpenzim prej 74.86 %, që është shpenzim solid dhe pjesa tjetër e mbetur besoj që do të shpenzohet, po do të shpenzohet edhe si para po edhe me punë kualitative.

z.Remzi Salihu: Nga parafolësit u ceken disa gjera për të cilat pata me diskutu edhe unë. Du mu ndërlihd tek mirëmbajtja e teknologjisë informative, ku thuhet se janë shpenzuar 12 mijë e 441 euro shikuar kështu realisht po me duket një shumë bukur e madhe dhe duke i ndarë veç e veç në drejtori siç janë sipas drejtorive, siç janë shpenzu këto mjete shofim se Zyra e Kryetarit ka shpenzu 3104 euro, pastaj kemi shuma tjera të cilat nuk do t'i ceku me ren. Kemi shumë nga një drejtori 82 euro e tjetra 62 e ku në Drejtorinë e Arsimit kemi shumë 5227 euro, po ndoshta që do të mund ta arsyetoja po të jete 40% e kësaj shumë mirëmbajtja e Zyrës së Kryetarit. Unë nuk e di se si ta thamë këtu ose kryetari është ka punon shumë e drejtorat nuk janë tu punu fare dikasteret të tjerë apo ndoshta thjeshtë kishte me qenë më mirë me e siguru kompjuterët të ri se sa me i riparuar. Tek prezantimi analitik i investimev për periudhën janar-shtator 2020, bazuar në përshkrimin e investimeve, vendeve dhe shumë e investimeve, shofim që kemi të bëjmë me një pabarazi kundër qytetarëve të komunës sonë. Shtrohet pyetja, si është kjo, sepse kjo që themë është më se e vërtet, mund ta vërtetosh po sa të fillosh se analizuar pasojat të konkuldon duke analizuar investimet e bëra në fshatrat e Komunës së Vitisë apo vendbanimet e Komunës së Vitisë, shifet se prej gjithsej 38 fshatra sa ka Komuna e Vitisë, kemi një renditje investime nëpër vendbanime. I kam të shënuara edhe vendbanimet po po shkoj vetëm me projekte. Kemi një vendbanim me 13 projekte, që është Vitia, pastaj dy vendbanime me nga 7 projekte të realizuara, një vendbanim me 6 projekte, dy vendbanime me nga 5 projekte, katër vendbanime me nga 4 projekte, gjashtë vendbanime me nga 3 projekte, pesë vendbanime me nga 2 projekte, gjashtë vendbanime me nga 1 projekt, por kemi edhe vendbanime ku nuk është investu fare asnjë cent për këtë periudhë kohore për të cilën po flasim. Pra, janë fshati Podgorc, Qifllak, Stubëll e Epërme, Letnicë, Ballancë, Devajë, Shusht, Trestenik me siguri që edhe këta gjinden ne Komunën e Vitisë. Për këtë bimë mund të themi që në këto vendbanime që kemi pas investime, ato kanë qenë tejet simbolike nga se shumica e investimeve janë paraqitur si investime në grupe në disa vendbanime, ku edhe shumë është paraqit si tërësi e këtyre investimeve, duke mos i veçuar specifikat për secilën vendbanim veç e veç, andaj lirisht munde të konkludojmë, se këto investime janë bë sipas radhitjes nga pesha e votës e jo sipas peshës së nevojës të qytetarëve dhe imperativës së kohës. P.sh.: në asnjërin nga investimet e bëra nuk ceket të ketë pasur investime në furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm apo rregullim të ndonjë kanalizimi apo grope septike për akumulim të ujërave të zeza, kur e dimi gjendjen se si është në Komune e Vitisë.

z.Ibrahim Rama drejtor: U parashtun një numër i pyetjeve, do të përpiqem në ato që kam informata, ndërsa për ato që nuk kam informata ju sjellim në mbledhjen e radhës. Pasqyrat financiare paraqesin shpenzimin e buxhetit që është miratu në Kuvendin e Komunës së Vitisë. Në këtë drejtim ju kam thanë shumë herë edhe po ju thamë, asnjë cent nuk është hargju as më shume e as më pak, as në kundërshtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave publike, që e parasheh buxheti po ne atë mënyrë qyshe është marr vendimi ne kuvendin komunal. Një përgjigje për Ekremi, që ka të bëjë me buxhetin e aprovuar, të alokuar dhe të shpenzuar, realish buxhetin dhe pasqyrat financiare paraqesin buxhetin, mjetet financiare që janë aloku edhe nga niveli qendror dhe nga të hyrat vetanake deri me 30 shtator 2020, bursat për studentet ke një pyetje, po është komisioni për shkak të problemeve që kanë këtë viti për shkak të Covid 19, komisioni ka përfundu punën e tij bazë konkursit të shpallur për bursë, atë studenteve. Listat janë të sakta, kryetari i komunës ka propozu që për hirë të situatës së përgjithshme ekonomike të mos përjashtohet asnjë student në kuptimin që ka apliku. D.m.th të gjithë studentët, përveq atyre që kanë dy bursa, edhe studentet

familja që i ka dy studentë, njani mundet me marr, ndërsa të gjithë të tjerët që kanë apliku kane përfitua bursa. Tani janë duke i kompletu konfirmimin e bankave dhe do ti marrin parat. Pyetje tjetër ishte vendimet e gjykatave. Unë kërkuesit të PDK-së ja kam sjellë në mënyrë analitike shpenzimet që kanë ndodh me këtë kod ekonomik. Pra, shuma është 50 mijë e 567 euro, 99% i kësaj shume janë për paga jubilarë dhe pensione. Kjo është një problem buxhetor, që është trashigu prej 2018 e kënj. Përpara të gjithë këta punonjës kanë pas të drejt në kenë kompenzim, po me buxhet nuk është planifiku prej 2019 e kemi buxhetin e saktë, jemi tu i realizu pa përmbarues privat të gjitha atyre që e meritojnë pagën jubilarë dhe pensionet. Ishte një pyetje tjetër që ka të bëjë me mungesën e mjeteve për shërbime dhe mallra. Po jemi frigu edhe ne që do të kemi një deficit së paku nga aspekti kur është planifiku të hyrat vetanake, po kemi ardh në përfundim dhe ja kemi arrit qëllimit, po me vendimin e juaj dhe të MAPL-së kemi pas dy intervenime financiare që e keni miratu ju, kështu që afër 400 mijë euro kemi pas shtim të buxhetit komunal për shërbime dhe mallra dhe besoj që këtë vit deri në fund të vitit fiskal do t'i realizojmë të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me shërbime dhe mallra. Investimet kapitale është një shpenzim solid baze të menagjerave të kontratave dhe të mbikëqyrësve, jemi në rrugë të mbarë që ta ekzekutojmë buxhetin në plotni deri në fund të vitit fiskal. Një pyetje ishte për trotuarin në Ramjan. Ai tretuar që është me asfalt, është i nivelit qendror i Ministrisë së Infrastrukturës dhe nuk ka pagesë që është paraqit në pasqyrat financiare, po është me asfalt, ndërsa ne një pjesë e kemi me kubza trotuarin. Ishte një pyetje për muzeun këtu që po rinovohet, është projekt i Komunës së Vitisë, marrëveshjen që e ka nënshkru kryetari i komunës me Fondacionin Kosovar për Trashëgimi Kulturorë. Shuma e projektit është 29 mijë e 500 euro, 15 mijë euro financon Fondacioni i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, kurse Komuna e Vitisë kemi nda mjete 14 mijë e 500 euro, për me e financua pjesën e dytë të këtij projekti. Procedurat dhe të gjitha punët tjera që kanë të bëjnë me ekzekutimin e këtij projekti, i udhëheq fondacioni i Kosovës, ne e kemi vetëm një monitruer që e përcjell punën bazë projektit që është i miratuar ne fondacionin e Kosovës. Disa pyetje tjera ishin p.sh.: për shpenzimet që kanë të bëjnë me mbeturinat, shpenzimet me udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Unë e kam shpjegu edhe herën e kalume edhe ne KPF, ky pozicion në pasqyra financiare na kërkon që me i përsëritë, se na raportojmë çdo tre muaj, po pasqyrat financiare paraqesin ekzekutimin e buxhetit tre muaj, gjashtë muaj dhe njëvjeçar. D.m.th edhe pyetjet po përsëriten. Udhëtimet zyrtare jashë vendit, kryetari i ka vetëm 164 euro, pjesa tjetër është vendimet e projektit krosburger, që ata e kanë realizu në Komunën e Vitisë dhe u kanë një ekskursion jashtë vendi dhe këto shpenzime ka qenë dashur patjetër me i parapa në këtë kod të shpenzimeve. Pastaj derivatet, këto janë që janë hargju, mirëmbajtja e autorrugëve, të gjitha janë në funksion të buxhetit të planifikuar për të gjitha drejtoritë, në asnjë pozicion, në asnjë nënkod, asnjë drejtori nuk e tejkalon atë që është parapa në buxhet.

z.Isak Sadiku, drejtor: Përshëndetej të nderuar të pranishëm! Në pyetjen e parashtruar nga Mirlinda dhe Jakupi, për derivatet dhe mirëmbajtjen e automjeteve, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me administratën komunale, mirëpo kemi të bëjmë me të gjitha automjetet dhe mirëmbajtje edhe për derivate të komunës sonë, të administratës komunale, i kemi karburant për vetura kemi shpenzu 9445 euro, kurse tek mirëmbajtja për administratë komunale është 6246 euro, e kemi krahasimin e shpenzimeve të vitit 2020 me të njëjtën periudhë të 2019, ku kemi tek derivatet e veturave, kemi dikun 7527 euro më pak në krahasim me periudhën e kaluar të vitit të kaluar, kurse tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, kemi dikun 2797 euro më pak se sa vitin e kaluar. Dëshiroj ta shpjegoj se nuk kemi të bëjmë këtu vetëm me 10 automjete, po kemi të bëjmë dikun me 40 automjete që i ka Komuna e Vitisë, si njësitin e zjarrfikësve. QKMF-në, administratën komunale.

z.Basri Aliu drejtor: Unë vetëm pata një sqarim lidhur me renovimin e shkollave. Ekremi e ngriti si çështje pata një sqarim se ne cilat shkolla është punu e që ka qenë e parapa me buxhet në investime kapitale, me buxhet prej 70 mijë euro. Kemi suvatimin e shkollës “Ndre Mjeda” në Kabash, ku është bë edhe rregullimi i tualetit dhe i ndriçimit të brendshëm; suvatimi i shkollës “Hysen Terpeza” në Terpezë, ku është bë rregullimi i tualetit dhe ndriçimi, kemi rregullimin e nxemjes në shkollën e Fshatit të Ri, ku kjo shkolla ka qenë pa nxemje. Tani e kemi nxemjen, gjithashtu nxemjen e kemi rregullu edhe në Sllatinë të Epërme, paralela e ndarë tek “Lagjja e Gjinollëve”, gjithashtu kemi nxemjen edhe në Buzovik, në shkollën e Buzovikut, rregullimi i tualetit në Smirë, rregullimi në shkollën “Dëshmorët e Vitisë” Këto janë të gjitha në kuadër të kësaj.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Unë po konsideroj që drejtori Isak e elaboroi mirë, po unë kisha me shtu diçka për hirë të opinionit. Ju e dini që me 13 mars është formu Komiteti për Emergjecë në Komunën e Vitisë. Në atë komitet që po i kalojmë 8 muaj, para disa dite kanë qenë mbledhje të rregullta javore, shtatë ditë në javë ne atë komitet është bë edhe shpërndarja e të mirave materiale, që herë pas here janë përdor edhe veturat e komunës, jo gjithherë në atë komitet është vendos që t'i ndihmohet policisë, Njësitit të Vitisë me automjet të komunës që i përdorim ne. Prandaj

tu i pas parasysh të gjitha këto i ndihmojmë edhe shoqatat që operojnë në Komunën e Vitisë, me autorizime të veçanta që bine në shpenzimet e këtyre derivateve, atëherë del se Komuna e Vitisë në harxhimin e derivateve del më së paku në nivel të Kosovës. Unë muj me e obligu drejtorin që në mbledhjen e radh ju sjellë shifrat se sa janë ndihmu jashtë institucioneve të Komunës së Vitisë, me autorizim nga ana e kryetarit për shoqatat që operojnë si veteran të luftës, organizatat e dalura nga lufta etj etj.

z.Bekim Azizi: Vetëm dua të lidhem se ne e dimë që renovimi i kësaj shtëpie të kulturës ka kushtu kogjo shumë, po ju pyes: a keni hi sot në banjo me këshyrë, a mundeni me hi që çfarë gjendje është banjo? Mundësish kamera, shif foton dhe i ftoj kamerat le t'i fotografojnë a munden me hi dikush këtu në tualet. Na e dimë që mbi 200 mijë euro ka kushtu renovimi i shtëpisë së kulturës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2019

z.Ibrahim Rama drejtor: Të nderuar të pranishëm, sigurisht e keni lexu me vëmendje informatën lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave financiare për Komunën e Vitisë për vitin fiskal 2019, çdo vit Zyra Kombëtare e Auditimit ka për detyrë që komunat në nivel të Kosovës me i kontrollu në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë dhe të gjitha akteve tjera që ka të bëjnë me paranë publike dhe me buxhetin e komunave, kryesisht auditorët në tri periudha gjatë punës së tyre punojnë në zyrat e komunës deri në përfundimin e raportit përfundimtar. Kështu që, një pjesë e punës është bë në 2018, një pjese 2019 dhe 2020 dhe në fund të gjithë këtij volumi të punëve që ata e kanë bë duke e kontrolluar një pjese të madhe të dokumentacionit përkatës nëpër të gjitha fushat e kategorive ekonomike, kanë ardh në përfundim, se në Komunën e Vitisë gjatë gjithë këtij viti janë gjetur 5 të gjetura, rekomandime, të cilat kanë të bëjnë me gabimet apo me defektet të cilat kane ndodh gjatë punës njëvjeçare. Rekomandimi i parë që e kanë gjetë auditorët është keqklasifikimi i shpenzimeve, si rezultat i pagesave nga thesari. Kryesisht ka të bëjë kjo me vendimet e përmbauesve privat, të cilët përmes Zyrës së Thesarit kanë inkasuar mjete nga buxheti i komunës për operatorët e ndryshëm që Komuna e Vitisë ju ka pas borxh. Pjesa dërmuese e këtyre mjeteve janë marr nga kodet që nuk kanë qenë adekuate të planifikuara me i pagu dhe në këtë drejtim ata këto mjete i kanë marr në të gjitha ato vende ku ka pas mundësi financiare për pagesë, kryesisht ka të bëjë me pagat jubileare dhe me një pjesë të vogël të një shpronësimi që ka ndodh para vitit 2014, janë marr mjetet nga ato pozicione ku nuk kanë qenë të planifikuara. Si gjetje e dytë ka të bëjë me dhënien me qira të pronës komunale, pa ju nënshtruar procedurës së duhur. Ne kemi mëndu, kryetari i komunës në konsultim me Zyrën Ligjore është mëndu dhe konfirmimi i Zyrës Ligjore ka qenë, se një kontratë mund të vazhdohet vetëm me vendim të kryetarit të komunës, duke e përfill Ligjin mbi Partneritetin Publiko Privat. Në këtë kundërshtim që e kemi pas në këtë pikë, nuk jemi pajtu as ne me këtë të gjetur të auditorit. Si e gjetur numër tre është dobësia në regjistrimin dhe menaxhimin e asetëve mbi 1000 euro. Edhe kjo e gjetur është e nivelit qendror, ministrive përkatëse, po ata naj kanë adresu neve. Janë objektet shkollore që i ka ndërtou niveli qendror, Ministria e Arsimit, MAPL-ja e ku dosjet që i kanë realizu në Komunën e Vitisë nuk naj kanë dhënë neve dosjen komplet të tenderit. Ne kemi bë shkresë disa herë në ministri, që mi pas ato dosje, po nuk i kanë sjell, e auditori ka bë si rekomandim edhe pse i niveli qendror. E gjetura numër katër është, vonesë në ekzekutimin e disa pagesave të cilat kanë ndodh gjatë vitit, dikun 17 mijë e 549 janë krejt vlere e pagesave që e kanë kalu afatin ligjor, që duhet mu pagu brenda 30 dite. Dhe rekomandim tjetër është edhe adresimi i ultë i rekomandimeve të Njësisë së Brendshme të Auditimit, që ka të bëjë me rekomandimet që i ka dhënë auditori brendshëm për problemet që janë në afarizmin, aplikimin e ligjshmërisë në qeverinë komunale. Dhe nga këto rekomandime, nga 22 rekomandime që i kemi pas nga auditori i brendshëm, 9 janë zbatuar në tërësi, 6 janë në proces të zbatimit, ndërsa 7 nuk kanë filluar së zbatuarit, kështu që, bazë kësaj ata naj kanë dhënë si rekomandim, se duhet të gjitha të gjeturat e auditorit të brendshëm t'i adresojmë dhe t'i eliminojmë, kështu që bazë të gjitha këtyre, auditori i jashtëm ka ardh në përfundim dhe ka thanë, se administrimi i parasë publike është kryer ne përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Besoj që deshmët e auditimit që kemi marr janë të mjaftueshëm dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion dhe janë për përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik dhe në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike kanë

ardh në përfundim, se Komuna e Vitisë bazë këtyre të gjeturave të kualifikohet me notën me opinionin e pamodifikuar, pa theksim të gjendjes. Ne jemi radhitë në komunat me disiplinë financiare të mjaftueshme dhe me not maksimale të cilën e jep Zyra Kombëtare e Auditimit të Brendshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë ju përgëzoj për punën e mirë që e keni bërë dhe ju inkurajoj që në të ardhmën të punojmë që edhe këto defekte t'i eliminojmë, që vitet tjera mos të kemi as këto të gjetura. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues. Kemi një informatë lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiar të Komunës së Vitisë për vitin përfundimtar deri me 31.12.2019. Kontrolli i rregullt që bëhet çdo vit, kontrolli që e nxjerr dhe e pasqyron punën, tu fillur prej kryetarit dhe Drejtorisë së financave, auditori në këtë kontroll është fokusuar në menaxhimin financiar dhe kontrolli i rekomandimit të vitit paraprak. Krejt këtu kemi opinionin që e nxjerr, kemi opinion të pamodifikuar, opinion të modifikuar dhe mohim i opinionit. Për fat të mirë Komuna e Vitisë nuk e ka as opinionin e modifikuar, as mohimin e opinionit, por me punë dhe angazhimin dhe paraqitjen e pasqyrave dhe shpenzimet, shpenzimeve financiare, kemi opinionin e pamodifikuar, që është një sukses, e arritur e komunës. Në këtë lëmi dhe në këtë drejtim të gjeturave janë pesë nga auditori i jashtëm, janë rekomandime që i mbetet Zyrës së Kryetarit dhe drejtorëve të punojnë në këtë drejtim dhe t'i eliminojnë këto defekte. I përgëzoj për punë dhe ju uroj punë të mbare e suksese në punën e mëtejshme.

z.Bekim Azizi: Tek raporti i auditimit një dokumenti, e tillë një informatë e mirë që vjen. Unë mendoj që është, mirëpo është shqetësuese që nuk janë zbatu rekomandimet që kanë qenë të mëhershme, plotësisht, së paku mendoj që rekomandimet që jepen duhet të kryhen. Është shqetësuese që nuk janë zbatu rekomandimet që kanë qenë më herët, plotësisht së paku mendoj që rekomandimet që jepen duhet të zbatohen ato rekomandime edhe pse me gjendjen në teren dhe gjendjen që shofim ne nuk e di pse nuk jepen shumë vërejte apo ndoshta drejtori i financave e ka mundësinë me i mbulu me letra ato dhe ata vetëm i këshyren letrat, tu i pas parasysh punët në teren qysh e kemi dhe kontratat që po i shofim dhe me dal një diçka e mirë, është kanjëher shqetësuese, e dimë p.sh.: se në 2019 ku ka qenë atje edhe në mirëmbajtjen e pjesës, p.sh.: e tenderit tek mirëmbajtja e varrezave, rrugëve. Na e dimë që atje ka qenë mirëmbajtja e varrezave, 68 varreza në nivel të komunës që janë parapa atje, asnjë nuk është mirëmbajt, asnjë nuk është aplikuar atje. Ka shumë projekte siç e përmenda më herët shifën në tendera çmimet që nuk janë as për së afërmi real.

z.Samet Idri: Përshëndetje të nderuar koleg! Gjatë seancës së mëhershme na u sill një dokument për shpenzimet. Më ra në sy kodi 43, shpenzimet e gjykatës dikun 50 mijë e 567 euro. Po du mu u ndërlihdh me vërejtjet e mija që i kam bërë gjatë diskutimit të pasqyrave financiare ndërvite. Unë gjithmonë e kam potencu, se nuk është mirë që të vonohen pagesat, pagesat duhet të behën me kohë për shkak se masandej mundet me pas prapavij dhe me bërë penallti qysh kjo qeveri lokale tash po thirret që po bënë pagesa të mëhershme, e tash e kemi këtu në mesin e pesë të gjeturave, e kemi edhe një gjetje ku auditori e konstaton se ka vonesa në pagesa të shpenzimeve, e në këtë rast, d.m.th kjo firmë me dashtë neve me na paditë tek përmbaruesi, me bërë pagesë shtesë jashtë kontratës. Këtu është një lëshim ekskluziv i drejtorit të financave. Sa i përket opinionit të auditorit, është opinionimi më i mirë i mundshëm, opinion i pamodifikuar mirë po mu qka me shqetësoj pak është se prej pesë të gjeturave dy të gjetura janë që lidhen ekskluzivisht me drejtorin e financave edhe me herët nese e keni ndegju drejtori tha që jame shume adekuat edhe në pagës atja i përcjelli pagesat e ne kete rast pikerish nje keq menagjim i shpenzimeve tek pagesa nga drejtori i financave unë kame një respekt per drejtorin sepse eshte nje profesionist, une e kame një kerkese prej drejtorit të financave që në pagesa të jete më azhur.

Kryesuesi z.Naim Pira: Po ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë pikë të rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Vitin 2019

z.Ibrahim Rama, drejtor: Të nderuar këshilltar komunal! Në piken para kësaj ishte raporti i auditimit, me ligj jemi të obliguar me e bërë një plan të veprimit për me i adresu këto të gjetura të auditorit të zyrës kombëtare. Në këtë

drejtim ne e kemi bënë një plan të veprimit, e kemi miratua në drejtori. Kryetari e ka miratu, e kemi dorëzuar tek Zyra Kombëtare të Auditimit dhe unë po pajtohem plotësisht me këto vërejtjet që u dhanë normal që ku punohet ka edhe gabime. Po ti eliminojmë edhe këto, po disa të gjetura janë të natyrës teknike, p.sh.: keqklasifikimi i shpenzimeve në pasqyrat financiare, ju e patë listën e shpenzimeve gjyqësore, d.m.th ato janë pjesë që kanë ndiku me pas na këtë rekomandim të keq klasifikimit pjesa dërmuese e këtyre keqklasifikimit janë pagat jubilarë 99%. Unë e shpjegova edhe tek pasqyrat financiare, kemi trashigu buxhet të pamjaftuar për pjesën e pagave jubilarë dhe të pensioneve deri në vitin 2018. Prej vitit 2018 i kemi planifikuar me buxhet. Në atë kohë jemi padi. Tash po na vinë vendimet gjyqësore. Shumë herë Zyra e Thesarit na pyet neve, Drejtorinë e Financave, ku mi marr paret. Unë sigurish e kisha adresë në ato rast kur me pyesin, po shumë herë ata nuk na pyesin, ku gjajnë mjete të lira i marrin edhe në vlerësim dalim që është keqmenagjim. E gjeta numër dy, dhënia e pronës me qira. Dëshmohet zbatimi i ligjit do të jete në zbatim edhe këtë të gjetur jemi konsultu, i kemi marr të gjitha informatat, e tani do të jemi në zbatim të ligjit. E gjetura numër tre, dobësitë në regjistrimi e menaxhim të pasurive, të aseteve të shkollave janë të nivelit qendror, kryetari ka bënë kërkesë zyrtare. Unë si drejtor, që sa herë ju kam bënë kërkesë na u është thënë që na mi bënë shkresë drejtpërdrejt me ndikim edhe politik, që ato dosje me i sjell në komuna, përndryshe na jemi krejt në rregull nëse ato dosje na vinë edhe kjo e gjetur sigurish kish mu eliminu. E gjetura numër katër, vonesat në ekzekutimin e pagesave. Kemi pas disa pagesa dhe kryetari i komunës pardje ka dhënë vendim që të gjitha drejtorive që vonesat mos të ndodhin ma. Edhe kjo eliminohet. Dhe adresimi numër pesë, këto janë rekomandime të auditorit të brendshëm, na ka dhanë rekomandim që nuk e kemi miratu, rekomandimet nuk i kemi adresu një pjesë të madhe, një përqindje edhe tek këto ne të ardhmen me vendos bashkërisht si institucion komunal, edhe pse auditori i brendshëm është zyre e kryetarit të komunës dhe raportet e tij janë të brendshme. Po auditori i zyrës kombëtare ka të drejt me e kontrollu edhe Zyrën e Kryetarit. Në këtë drejtim na është thënë, që rekomandimet e Zyrës së Brendshme të Auditorit, t'i adresojmë 100% dhe t'i realizojmë në vazhdimësi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, kalojmë tek ika radhës.

Si pikë të pestë e të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të propozim rregullorë për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

Kryesuesi z.Naim Pira: Është një rregullorë që na ka ardh nga niveli qendror dhe kontribut kanë dhënë organizatat joqeveritare. Është e njëjtë thuaj për tërë komunat, na kane sugjeruar që brenda këtij viti ta miratojmë, andaj nëse ka për diskutim, hapi debat nëse jo kjo rregullorë do të dal në diskutim publik. Nga të gjitha të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Pa keni para jush një propozim vendim i cili vjen nga ana e kryetarit ju e dini që të gjitha pronat që jepet në shfrytëzim. Tash e tutje po shkojmë bazë procedurave, megjithatë duhet pasi të shkon përmes ankandit të ekziston një komision I ankesave, sepse mundet me pas ankesa nga ata që paraqiten në ankand. E pikërisht duhet të kemi komisioni për shqyrtimin e ankesave. Dy anëtar duhet të jen nga ekzekutivi, dy nga legjislativi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

z.Basri Sylejmani: Unë nga radhët e LDK-së e propozoj, z.Nuredin Lutfiu anëtar të këtij komisioni.

z. Jakup Demiri: Unë propozoj Sejdi Eminin nga LVV-ja.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mbetet nga ekzekutivi t'i sjell emrat edhe nga shoqëria civile, tani qes në votim për miratim. Nga të gjithë u mirat kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtat të rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale NPSH “ARENA SPORT” në Kabash

z.Hasan Aliu nënkryetar: MAPL-ja e ka kthyer këtë vendim të miratuar nga ana e juaj për shkak se ka kërkuar dokumentacione komplet dhe dokumentacioni që e kemi dërguar ne e ka gjetur një gabim teknik të cilën sipas tyre nuk ka mundësi me e tejkaluar, se në kërkesën e përfaqësuesit të “Arena Sport” ka qenë vazhdimi i kontratës për shfrytëzimin e pronës, ndërsa në procedurë ne kemi vendosur për dhënien e pronës dhe pikërisht për këtë kanë thanë që kërkesa duhet të përimitohet, megjithatë ne jemi obligativ ta rikthejmë në kuvend, sepse këto monitorohet.

z.Bekim Azizi: Na e kemi kaluar njëherë e kalojmë prapë, po këtu tek fleta poseduese nuk e di, u përshtill diçka rruga “Adem Jashari”. E dimë që kjo rrugë është në Viti.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratua.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal e kryetarit të komunës së Vitisë me komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj

b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të komunës së Vitisë me komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj

c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Këtë mënyrë e parashih ligj, se si të veprohet që kryetari të ketë mundësi të lidh marrëveshje të bashkëpunimit. Tash bisedohet për rrugën Ballancë-Kravaricë, është rruga Verban-Begracë, janë shumë rrugë që nevojitet një autorizim i tillë, që me pas mundësi me pas marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim e qes në votim për miratim. Konstatohet që u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Informatë për raportin e performances për vitin 2019 të Komunës së Vitisë

z.Hasan Aliu nënkryetar: MAPL-ja si ministri përkatëse e cila e bënë monitorimin e të gjitha komunave lidhur me raportin e performances, megjithatë në këtë vit bazë të performances është një diskrepancë, sepse bazë organizatave në llogaritmi të parët, ndërsa nga ana e MAPL-se jemi llogarit dikur 21, megjithatë jemi një prej komunave të cilët e kemi fituar grandin, grand të cilën pas disa ankuesve e kanë pezulluar ministri i ministrisë përkatëse, megjithatë unë besoj që janë mjetet që i kam propozuar edhe kryetarëve të komunave që me bë padi në gjykatë, sepse ai grand duhet me na taku, sepse kemi hi në garë, i kemi fituar dhe pas garës nuk mundesh me ja kontestu dikujt këto çështje, duhet të rregullohen paraprakisht. Këtë javë kemi punuar shumë që ti ngrisim ata indikator që janë matës dhe që maten, që më të vërtet edhe Komuna e Vitisë të llogaritet një prej komunave me të mirat. Ka edhe çështje që duhet ta pranojmë nuk i kemi kryer, ne kemi shumë prona që i japin në shfrytëzim. Ishmi të obliguar që çdo dhjetor na me e prur listën e pronave që kemi me i dhënë vitin 2021. Ne nuk e kemi bërë këtë, e kemi bërë vetëm kur kemi pas kërkesa këtu, kemi marr zero poena.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Një raport i performancës siç ke një raport i auditimit që na erdh mirë që është i mirë, e raporti i performances nuk është bash i mirë, sepse jemi të renditur nënmesataren e komunave, jemi të renditur në numrin 21. Unë edhe në KPF e kërkoja atë pjesën e tabelës kryesore që janë të renditura komunat veç e veç, po prapë nuk na ka ardh medoj që edhe ajo e kish kompletu këtë. Nuk e di qysh e masin performancën, po për shembull tek parkingjet publike na e dimë që parkingjet publike vetëm çka janë zvogëluar, nuk janë rritur, pra që preferohen me u rritur. Shembull tjetër kanalizimet, kemi 38.53, a është përqindje apo vlerë nuk e di, mirëpo është pikë që është e

llogaritur kjo, na e dimë qysh është gjendja me kanalizime. Na e dimë që ujë të pijshëm nuk kanë as 30% e shtëpive në Komunën e Vitisë, që domethanë jemi poshtë, për këtë jemi vlerësu me pak pikë ose menaxhimi i mbeturinave 39.93. Këto janë elemente që e prekin çdo qytetar dhe kemi marr pikë shumë pak, që këto e kanë ul vlerën e përgjithshme. Kur të himë në totalin e vlerave të përgjithshme tek pikët.

Kryesuesi z.Naim Pira: Është mire që na ka ardh raporti i performances në kuvend edhe të debatojmë. Mu më përket me tepër me fol për punën e kuvendit, të cilën e kemi ne, sepse p.sh.: dy indikator që aty na kanë qit performancë jo të mirë është sjellja e buxhetit para datës 15 shtator në Zyrën e Kuvendit Komunal që nuk ka ndodh vitin e kaluar. Po tash kemi marr hapa dhe pikërisht me 15 shtator naj kanë sjellë dhe një tjetër, është plani i veprimit për të gjeturat, na e kemi pas pru bashke me informat të auditorit dhe nuk jemi vlerësu maksimum, ndërsa për vitin e ardhshëm kuvendi do të del edhe më mirë, edhe pse shumë organizata të tjera neve na renditin shumë lartë. Pasi që nuk ka të tjerë me diskutu, i kemi edhe dy pika të tjera, është një propozim nga LVV-ja, i cili u ardh në KPF nga Jakupi, të cilin e kemi diskutu edhe kryetarët e grupeve parlamentar me një takim dhe kemi aprovu.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

10. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për çdo viktimë të Covid 19 në Komunën e Vitisë

Kemi diskutu dhe e kemi gjetë formën dhe mudësinë me të mirë. Ata të cilët kanë nevojë ju adresohen zyrës, ashtu kemi mëndu, sepse nuk kemi dashtë me e lëndu dikan. Unë hapi debat për këtë pikë, nëse ka për diskutim?

z.Samet Idrizi: Kërkon që të caktohet çështja e vlerës, sa para sa do të jetë kjo ndihmë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Jemi pajtu që vlera të jete 500 euro.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të njëmbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

11. Propozim vendim për ndryshim-plotësim të vendimit paraparak 01-110/5-541, të datës 30.06.2020, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

Nënkryetari në fillim e sqaroi këtë pikë, unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
